# AKT THEMELIMI I SHOQERISE "ORION" Sh.p.k.

DHIMITRAQ DHIMITRI, I biri I LLAMBROS, I datelindjes 1955, lindur e banues ne Tirane shpreh deshiren, sipas kerkesave te ligjit nr. 7667 date 28.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare" dhe vendos sa me poshte:

NENI 1

Te krijoje shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "ORION" sh.p.k. e cila do te veproje ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, dispozitat e kesaj kontrate, me statutin e perbashket dhe ligjin 7667, dt. 28.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare. Kjo shoqeri do te emertohet "ORION" sh.p.k.

NENI 2

Shoqeria "ORION" sh.p.k. do te kete qendren ne Tirane, Rr. "Punetoret e Rilindjes", pallati Partizani, shk. 1, Ap. 5 dhe do te ushtroje veprimtari per nje periudhe kohe te pakufizuar, mbi 20 vjet me te drejte perseritje per periudhen e metejshme, n.q.s. ortaku I vetem bie dakort, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

NENI 3

Shoqeria "ORION" sh.p.k. do te kete per objekt te veprimtarise se saj:

- Projektimi, zbatimi ne fushen e ndertimeve civile, turistike, bujqesore, ekonomike, veshje fasadash, banesa, hotele, objekte kulti, rruge, infrastrukture, rikonstruksione civile, mirembajtje, zhvillim dekori ne mjedise urbane etj.
- Prodhimi, perpunimi I materialeve te ndertimit, transportimi dhe tregetimi I tyre.
- Magazinimi dhe shperndarja e materialeve te ndertimit.
- Organizimi dhe paisja e panaireve dhe ekspozitave, sherbimeve, reklama dhe marketingu.
- Importi dhe eksporti I materialeve te ndertimit, tregetimi I tyre me shumice dhe pakice.

NENI 4

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin, vendqendrimin dhe objektin e veprimtarise se saj sipas vendimeve qe do te merren me miratimin e ortakut te vetem.

NENI 5

Per realizimin e objektivave te shoqerise ortaku bie dakort te vendose kapitalin e tij, per persosjen e organizimit e zhvillimin e veprimtarise se saj. Kapitali themeltar I shoqerise do te jete 100.000 leke te reja dhe perbehet nga kontributet si me poshte:

1. DHIMITRAQ DHIMITRI me 100.000 leke

I gjithe kapitali themeltar eshte nenshkruar e shlyer krejtesisht, pastaj I eshte ndare ortakut si me siper. Cdo kuote I takon e drejta e nje vote.

NENI 6

Kapitali I shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimeve qe do te marre ortaku. Ne rast se kapitali I shoqerise per shkak te humbjeve te vertetuara ne dokumentat financiare, rezulton me I vogel se gjysma e kapitalit themeltar, ortaku vendos brenda tre muajve nga miratimi I llogarive te percaktoje kete humbje mbi mundesine e prishjes se parakohshme te shoqerise. Ne rast se prishja nuk shpallet, shoqeria zvogelon kapitalin e saj me nje vlere jo me te vogel se ajo e humbjeve qe kane mbetur, pa mbuluar fondet rezerve.

## NENI 7

Ortaku mund t'u shese te treteve kuota te kapitalit te tij, teresisht apo pjeserisht te shoqerise, te cilet kane te drejten e parablerjes qofte edhe ne kushte te barabarta. Kjo e drejte duhet ushtruar brenda 30 diteve nga data e komunikimit.

## NENI 8

Organet drejtuese te shoqerise jane:
-Ortaku I vetem
-Administratori
-Drejtuesi teknik (likujdatori )
Procedura per emerimin ne funksionet perkatese dhe shkarkimin e tyre rregullohen sipas statutit te shoqerise.

## NENI 9

Asambleja drejtohet nga administratori I shoqerise. Ortaku themelues I shoqerise zgjedh si administrator te saj Z. DHIMITRAQ DHIMITRI.

## NENI 10

Vendimet e Asamblese jane te vlefshme nese jane miratuar nga ortaku I saj. Vendimet e ortakut te vetem mund te merren edhe nepermjet konsultimit me shkrim.

## NENI 11

Likuiditetet dhe transaksionet financiare do te depozitohen ne bankat shqiptare dhe ne ato te huaja, ku shoqeria ka llogarite e saj rrjedhese.
Per kapitalin themeltar te shoqerise eshte hapur libri I llogarive ku do te shenohet kontributi I ortakut te vetem. Po keshtu shoqeria ka dhe perdor dokumentacionin sipas kerkesave te ligjit per kontabilitetin e gjithe kerkesave te tjera financiare, te domosdoshme per veprimtarine normale te saj.

## NENI 12

Fitimi neto I realizuar nga shoqeria I mbetet ortakut ne perpjesetim me kontributin ne kapitalin themeltar te shoqerise, mbasi te jene likuiduar te gjitha detyrimet, dhe te jete hequr 5% qe do te futet ne fondin e rezerves ligjore deri ne permbushjen e 1/10 te kapitalit te shoqerise.

## NENI 13

Shoqeria fillon veprimtarine e saj vetem pasi te kete marre autorizimin e organeve kompetente sipas legjislacionit ne fuqi.

NENI 14

Ortaku eshte I detyruar te ruaje karakterin sekret te dokumentacionit, te eksperiences se shkembyer te realizuar brenda veprimtarise se shoqerise.

NENI 15

Te gjitha mosmarreveshjet qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim do te paraqiten per zgjidhje ne gjykaten kompetente shqiptare ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

NENI 17

Kjo kontrate u perpilua ne prani te ortakut te vetem duke shprehur ne te vullnetin e lire te tij.
Kjontrata u perpilua ne tre kopje me fuqi te barabarte secila per t'u depozituar ne organet gjyqesore dhe tatimore si dhe nje kopje te ruhet ne dokumentacionin baze te shoqerise.

ORTAKU THEMELOR I SHOQERISE "ORION" SH.P. K.,
DHIMITRAQ DHIMITRI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. REP. 3275/2754

VERTETIM

Ne Tirane, sot me 12.05. 1998, para meje noteres Fatmara Shehu, notere e Dhomes se Noterise, Tirane, me seli ne rrugen Zhan D'Ark, u paraqit Z.DHIMITRAQ DHIMITRI, I biri I Llambros, dtl. 1955 banues ne, Tirane, certifikate e leshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Njesia 2, me fotografi, me Nr. 1/56 madhor e me zotesi te plote per te vepruar, I cili deklaroi se kete akt themelimi e ka redaktuar me vullnetin e tij te plote e te lire, jashte kesaj zyre dhe e nenshkroi ne prezence te noteres. Une, noterja, e vertetoj sipas ligjit.

NOTERE

RULLE-TAKSE 50 LEKE SHQIPERISE

NOTERE FATMARA SHEHU TIRANE ALBANIA

STATUT I SH.P.K. "ORION"

KREU I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar emertohet "ORION" sh.p.k.
Shoqeria eshte nje person juridik shqiptar. Shoqeria fiton te drejten e personit juridik nga data e regjistrimit ne gjykate. Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar, me dispozitat e parashikuara ne dokumentat e krijimit te saj, kontraten e kete statut, si dhe ne ligjin nr. 7638, dt. 19.11.1992. 7667 date 28.01.1993

NENI 2

Shoqeria "ORION" sh.p.k. ka statusin e personit juridik dhe vulen e saj.

NENI 3

Shoqeria "ORION" sh.p.k. ka seline ne Republiken e Shqiperise, Tirane, , L.2, P.9. Ajo mund te cele filiale, dege e perfaqesi ne qytete te tjera te Shqiperise dhe jashte saj.

NENI 4

Pjesemarrja ne shoqeri nuk e pengon ortakun te kete pavaresi ligjore, organizative dhe te drejte pronesie jashte Shqiperise. Po keshtu shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet e ortakut te saj jashte veprimtarise se shoqerise.

NENI 5

Shoqeria "ORION"sh.p.k. do te kete per objekt te veprimtarise se saj:

- Projektimi, zbatimi ne fushen e ndertimeve civile, turistike, bujqesore, ekonomike, veshje fasadash, banesa, hotele, objekte kulti, rruge, infrastrukture, rikonstruksione civile, mirembajtje, zhvillim dekori ne mjedise urbane etj.
- Prodhimi, perpunimi I materialeve te ndertimit, transportimi dhe tregetimi I tyre.
- Magazinimi dhe shperndarja e materialeve te ndertimit.
- Organizimi dhe paisja e panaireve dhe ekspozitave, sherbimeve, reklama dhe marketingu.
- Importi dhe eksporti I materialeve te ndertimit, tregetimi I tyre me shumice dhe pakice.

KREU 2

TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKUT TE VETEM

NENI 6

Ortaku I vetem ka keto te drejta kryesore te cilat ushtrohen nepermjet vendimeve te marra nga Asambleja:

1. Te marre pjese ne administrimin e veprimtarive ekonomike tregtare te shoqerise ne perputhje me kontraten dhe statutin.
2. Te marre pjese ne ne rezultatet e veprimtarise se shoqerise, ne cdo forme e sasi qofte sic parashikohet nga kontrata e statuti
3. Te kerkoje e t'I jepen te gjitha informatat qe kane te bejne me gjendjen tregetare dhe veprimtarine e shoqerise si dhe gjithe dokumentat e perpunuara nga shoqeria duke ua ofruar kuoten e tij te treteve, te cilet kane te drejten e pare te blerjes. Ai ka te drejte te shese te personat e trete.

NENI 7

Ortaku ka keto detyra kryesore:
1. Te depozitoje kuoten fillestare dhe kuoten eventuale suplementare ne perputhje me kontraten dhe statutin.
2. Te drejtoje administrimin e shoqerise nepermjet organeve te krijuara nga ai vete.
3. T'I jape shoqerise te dhenat e domosdoshme per perpunimin e cdo objekti te vecante ne veprimtarine e saj.
4. Te kryeje detyrat per realizimin e objektivave dhe te funksioneve qe ka.

NENI 8

Ortaku ka te drejte te heqe dore nga shoqeria duke ia njoftuar me shkrim vendimin e tij organit administrativ 2 muaj perpara dhe duke proceduar te drejten e rrjedhjes sipas nenit 6.
Heqja dore nga shoqeria nuk e liron ortakun nga detyrimet financiare te marra me pare ndaj shoqerise dhe nuk pezullon detyrimet ndaj ortakut.

KREU 3

KUSHTET EKONOMIKE

NENI 9

Veprimtaria e shoqerise realizohet ne baze te leverdise ekonomike dhe pasqyrohet ne bilancet e saj.

NENI 10

Per te bere te mundur zhvillimin e veprimtarise te shoqerise vihet nje kapital baze prej 100.000 leke te reja qe perbejne burimin fillestar per krijimin e fondit themeltar. Ortaku krijon kapitalin themeltar te shoqerise sic percaktohet ne kontraten per krijimin e shoqerise.

NENI 11

Shoqeria do te kryeje veprimtarine e saj pa kufizim, ne cdo rast mbi 20 vjet. Kur shoqeria pushon veprimtarine e saj, pasi shlyen te gjitha detyrimet qe ka, pjesen e mbetur te kapitalit dhe te te ardhurave e mban ortaku ne perpjesetim me kuoten e vene per krijimin e kapitalit baze te shoqerise.

NENI 12

Shoqeria eshte pronare, perdoruese dhe disponuese e pasurive te saj, ne emer te vet, ne perputhje me qellimin dhe objektivin e veprimtarise se saj.
Shoqeria mund te bleje dhe shfrytezoje te drejtat materiale ose jo, perfshire te drejten per ofruar pasurite e saj dhe per te marre kredi bankare.

NENI 13

Shoqeria krijon fondin rezerve dhe fonde te tjera te vecanta financiare (per zhvillimin e saj dhe per nxitjen ekonomike te valutes etj.) Perberja, shuma e pergjithshme, burimet dhe krijimin e fondit rezerve, perdorimi dhe rregullimi I cdo fondi te vecante caktohen nga asambleja e ortakeve.
Shoqeria I disponon plotesisht mjetet e saj financiare. Detyrimet qe mund te lindin gjate veprimtarise se saj mbulohen nga fondi rezerve, perdorimi dhe rregullimi I cdo fondi te vecante caktohen nga asambleja e ortakeve.
Shoqeria I disponon plotesisht mjetet e saj financiare.
Detyrimet qe mund te lindin gjate veprimtarise se saj, mbulohen nga fondi rezervedhe nga fondet e tjera osse nga shumat suplementare qe mund te derdhe ortaku, kur detyrimet nuk mund te mbulohen nga fondet ekzistuese.

NENI 14

E ardhura bruto e shoqerise pasi zbritet amortizimi I te gjitha passurive te luajtshme e te paluajtshme, sipas rasteve te caktuara, kuotat qe kane te bejne me kredite per investime, pagat dhe shtesat mbi pagat, shpenzimet per lendet e para ndihmese apo energjine si dhe per shpenzimet e pergjithshme te shoqerise dhe per ato qellime te tjera tregetare dhe jo tregtare etj. Per rezerve financiare caktohet 5% e fitimit (zbritur humbjet eventuale te viteve te meparshme te pambuluara) deri sa ky fond te arrije sa 10 % e fondit themeltar, pjesa e mbetur I ngelet ortakut te vetem te shoqerise.
Ortaku mund te vendose te shperndahen shumat e vena menjane per rezerven qe ajo ka ne dispozicion duke treguar shprehimisht llojet e rezervat ku jane marre keto shuma. Asnje shperndarje nuk mund te behet nese kapitalet e veta jane ose do te beheshin pass kesaj shperndarje me te vogla se ssa shuma e kapitalit qe nuk lejohet te shperndahet, sipas ligjit apo statutit.

NENI 15

Bilancet vjetore duhet te paraqiten brenda dates 31 mars te vitit pasardhes nga organi administrativ pasi ta kete shqyrtuar me pare asambleja.

NENI 16

Veprimtaria financiare e shoqerise realizohet ne baze te planeve financiare qe bejne pjese ne planin e veprimtarise ekonomike tregtare.
Planet financiare parashikojne aktivin dhe pasivin e veprimtarise se shoqerise, te shprehura ne leke.
Llogaria kontabel dhe ajo ekonomike mbahen ne leke. Rezultatet financiare te veprimtarise se shoqerise caktohen ne baze te bilancit vjetor.
Shkembimi I monedhes shqiptare ne monedhe te huaj behet ne perputhje me kursin e caktuar nga Banka e Shtetit Shqiptar.

KREU 4
ADMINISTRIMI

NENI 17

Organi vendimor I shoqerise eshte Ortaku I vetem I shoqerise. Ai vendos per bilancin vjetor, per ndryshimet ne statut, per shtimin ose pakesimin e kapitalit themelor te shoqerise, kundrejt te treteve, per emerimin e organit administrativ si dhe per pushimin apo rritjen e veprimtarise se shoqerise, percakton gjitTiranehtu drejtimet kryesore te veprimatrise se shoqerise.

NENI 18

Organi Administrativ I shoqerise emerohet ose riemerohet ne funksionet e tyre nga ortaku I vetem, perfaqeson shoqerine, kundrejt te treteve brenda caqeve te objektit te veprimtarise se shoqerise, pervec ceshtjeve qe duhen vendosur nga ortaku I vetem. Administrator eshte Z. DHIMITRAQ DHIMITRI.

NENI 19

Organi Administrativ eshte kompetent per te marre vendime per:

1. Te therras mbledhjen per ortakun e vetem me shkrim 15 dite me pare.
2. Te miratoje planet e llogarite ekonomike mujore dhe tre mujore, pas perpunimeve te tyre ne kuadrin e objektit te shoqerise duke perfshire edhe kuadrin e personelit.
3. Te propozoje strukturen e aparatit te shoqerise.
4. Te percaktoje ndarjen e vendeve te punes te atyre qe do te merren ne pune.
5. Te beje propozime per rregullimin , krijimin dhe destinimin e fondeve te vecanta, ndarjen e fitimeve si dhe percaktimin erregullave lidhur me shlyerjen e borxheve.
6. Te paraqese propozimin per pushimin e veprimtarise se shoqerise.
7. Te perzgjedhe anetaret e komisionit te likuidimit , te cilet emerohen dhe revokohen nga ortaku I vetem.
8. Te kryeje veprimtari per likuidimin e llogarive.
9. Te perfaqesoje shoqerine ne veprime gjyqesore.

NENI 20

Marredheniet e punes se shoqerise rregullohen nepermjet kontrates se punes.
Per ceshtje qe nuk rregullohen ne kontraten e punes zbatohen dispozitat e legjislacionit te punes.

KREU 5

MBYLLJA E SHOQERISE

NENI 21

Veprimtaria e shoqerise pushon sipas propozimit te bere nga organi administrativ kur veprimtaria rezulton negative ose kur ortaku heq dore nga shoqeria si dhe ne te gjitha rastet e tjera qe parashikohen ne kontrate.
Shoqeria shperndahet ne formen e riorganizimit ose te likuidimit.

NENI 22

Kur shoqeria likuidohet:

1. Ortaku I vetem emeron komisionin e likuidimit. Shoqeria I jep fund veprimtarise se saj ne castin e miratimit te bilancit te likuidimit.
2. Pasurite qe jane vene ne dispozicion te shoqerise me te drejte shfrytezimi I kthehen ortakut pronar dhe vlkeresimi I shfrytezimit te bere (te gezuar) llogaritet ne shumen qe I duhet kthyer ortakut pronar.
3. Mjete financiare te fituara si rezultat I veprimtarise se shoqerise e te filialeve te saj si dhe fondet e tyre financiare I mbeten ortakut, pasi te jene bere pagesat per kreditoret.

NENI 23

Kur pushon veprimtaria e nje filiali per efekt riorganizimi te tij, afatet e pushimit caktohen nga ortaku I vetem.
Likuidimi I filialeve behet ne te njejten menyre sic procedohet per shoqerine.
Mjete financiare te fituara si rezultat I veprimtarise se filialit te likuiduar dhe fondet e tij financiare vihen ne dispozicion te shoqerise, pasi t'u jene bere pagesat kreditoreve.

Pasi behet njeftimi I mbylljes ose likuidimit dhe kryhen formalitetet perkatese, shoqeria cregjistrohet nga regjistri tregetar.

## KREU 6

## DISPOZITA TE PERGJITHSHME

### NENI 24

Persa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut, I referohet plotesimeve qe do te behen nga ortaku I vetem I shoqerise si dhe ligjeve te vecanta te legjislacionit shqiptar.
Ndryshimet dhe plotesimet e ketij statuti behen ne te njejten menyre e procedura me te cilen nxirret vete statuti.
Ndryshimet nuk prekin personalitetin juridik te shoqerise.

### NENI 25

Te gjitha kundershtimet eventuale I nenshtrohen kompetences te nje kolegji te perbere prej tre arbitrash nga te cilet secila pale cakton nga nje arbiter, ndersa I treti caktohet nga dy te paret ose nga kryetari I gjykates se rrethit. Arbitrat kerkojne zgjidhjen ne mirekuptim dhe vendimet e tyre do te pranohen nga palet ne konflikt si shprehje e vullnetit te tyre. Vendimet merren ne vendin dhe kohen e parashikuar nga ortaku I vetem.

### NENI 26

Vendimet e kolegjit te arbitrave, nese njera nga palet nuk eshte dakort mund te behen konflikt gjyqesor ne gjykaten e rrethit.

ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE
"ORION" Sh.p.k.
DHIMITRAQ DHIMITRI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. REP. 3216 NR. KOL. 255

**VERTETIM**

Sot ne Tirane, me date 12.05. 1998 ,para meje Fatmara Shehu notere e dhomes se notereve me seli ne rrugen Zhan D ' Ark, m'u paraqit DHIMITRAQ DHIMITRI,ibiri Llambros, lindur me 8.7 .1955 ne Tirane, banues ne Tirane,,rr.P.Rilindjes,pall.Partizani,shk.1,ap.5,me çertifikate lindje me fotografi nr?1/56 date 12.3.1997 leshuar nga zgjc L.2 Tirane, me shtetesi shqiptare,madhor, me zotesi te plote juridike e per te vepruar, i cili deklaroi se sa siper,jashte kesaj zyre, ka hartuar statut per krijim e shpkOriondhe pasi ka nenshkruar sipas ligjit,une noteri e vertetoj